

VENDIM
Nr. 675, datë 7.8.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 366, DATË 13.5.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË SË ERSEKËS TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 8/a shkronja “b” të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë bashkisë Ersekë dhe heqjen nga lista e inventarit, të miratuar me vendimin nr. 366, datë 13.5.2011 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht, për pronën 1/2 e Librarisë Qendrore Ersekë, pjesë e pronës 58, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Ersekë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i Pushtetit Qendror Bashkia Ersekë Fusha e përdorimit të pronës: Kulturë dhe sport										
Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kad. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës m ²	Nga sip. totale, sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
57	1594 E-5 E-4	5/67	Bareliev	Bazorelievi i muzeut te muzeu në sheshin “Rilindja”, Ersekë		21	Bazorelievi i muzeut	Ministria e Kulturës Bashkia Ersekë	Bashkia Ersekë	Bazorelievi në bronz, me përmasa 3*7m, te fasada kryesore e muzeut
58	ER-1594 E-4	8/27	Ndërtesë	Ambient në katin përdhe të ish-Shtëpisë së Pionierit, bulevardi i “Dëshmorëve”	92	83	Ish- biblioteka, në katin përdhe	Ministria e Kulturës Bashkia Ersekë	Bashkia Ersekë	Ambienti është në katin përdhe të godinës 2- katëshe, në bashkëpronësi
59	1594 F-4 F-4	9/121	Ndërtesë truallë	Stadiumi “Gramozi” rruga e “Dëshmorëve”	16229		Stadiumi i qytetit	Ministria e Kulturës Bashkia Ersekë	Bashkia Ersekë	
60		9/118	Truall	Fushë në perëndim të stadiumit	8783		Fushë stërvitje e ekipit të Gramozit	Ministria e Kulturës Bashkia Ersekë	Bashkia Ersekë	